

Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen SoS2LearnDBS CLed për Ruajtjen e Oqeanit dhe Ujërave në Rajonin e Lumit Danub dhe Detin e Zi

Synimi i thirrjes:

Thirrja ka për qëllim të mbështesë veprimtari lokale të udhëhequra nga komunitetet, të cilat kontribuojnë në objektivat e Misionit “Restore our Ocean and Waters” në Rajonin e Lumit Danub dhe Detin e Zi dhe adresojnë objektivat dhe synimet e Misionit Oqeani 2030. Projekti synon të fuqizojë komunitetet lokale për të marrë një rol aktiv në adresimin e sfidave mjedisore dhe shoqërore përmes zbatimit të zgjidhjeve bazë nga konsorciume të vogla partnerësh rajonalë, duke implementuar zgjidhje nga baza për zhvillim të qëndrueshëm dhe restaurim të ekosistemeve ujore.

Objektivat e thirrjes:

- Projekte restaurimi të habitateve detare.
- Iniciativa për reduktimin e ndotjes nga plastika.
- Programe për peshkim të qëndrueshëm.
- Iniciativa për gjurmimin dhe pastrimin e mbeturinave detare.

Kush mund të aplikojë:

Subjektet e pranueshme për të aplikuar janë:

- **Autoritetet rajonale dhe vendore, duke përfshirë bashkitë dhe administratat rajonale.**
- Organizatat joqeveritare (OJQ), fondacionet, shoqatat profesionale dhe organizata të tjera të shoqërisë civile të angazhuara në zhvillimin lokal, qëndrueshmërinë ose mbrojtjen e mjedisit.
- Institucionet arsimore, të tilla si shkollat, universitetet ose institucionet profesionale.
- Kompanitë lokale dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme aktive në fusha relevante për thirrjen (p.sh. eko-inovacioni, menaxhimi i ujit, peshkimi i qëndrueshëm), me kusht që kjo të mos bie ndesh me rregullat e Ndihmës Shtetërore.
- Organizatat që kryejnë kërkime, duke përfshirë universitetet, institutet publike të kërkimit dhe qendrat e inovacionit.
- Entitete të tjera të formuara zyrtarisht që përfshihen në kornizën e Komuniteteve të Misionit, duke përfshirë ato që përfaqësojnë:
 - Portet dhe portet e brendshme
 - Ishujt dhe komunitetet bregdetare
 - Komunitetet e peshkimit ose akuakulturës
 - Grupet e ruajtjes
 - Qytetet ose rajonet bregdetare
 - Organizatat e sektorit të turizmit
 - Operatorët e infrastrukturës detare

Udhëheqësi i konsorciumit duhet të jetë i vendosur në një nga këto vende: **Shqipëri**, Austri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Gjeorgji, Gjermani, Hungari, Itali, Moldavi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Turqi ose Ukrainë.

Partnerët e konsorciumit mund të jenë të regjistruar në çdo shtet anëtar të BE-së ose vend të asociuar me Horizon Europe.

Fushat dhe tipet e aktiviteteve të pranueshme:

Propozimet mund të përqendrohen në: restaurimin e habitatit detar, reduktimin e ndotjes nga plastika, programe peshkimi të qëndrueshëm, monitorimin dhe pastrimin e mbetjeve detare. Projektet mund të përdorin teknologji, zgjidhje natyrore, qasje sociale dhe kulturore, ose metoda të reja të menaxhimit dhe financimit për restaurimin e ujërave. Objektivat duhet të përfshijnë ndërtimin e kapaciteteve, promovimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet komuniteteve lokale.

Zonat përfituese:

Projekti mbulon të gjithë rajonin e Lumit Danub dhe Detin e Zi, duke përfshirë zonat e mëposhtme: **Shqipëri**, të gjithë Ballkanin Perëndimor, Austri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Gjeorgji, Gjermani, Hungari, Itali, Kosovë, Moldavi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Turqi dhe Ukrainë.

Buxheti i thirrjes:

Ka dy lloje aplikimesh për fonde:

- **Tier 1 nga 200,000€ deri 400,000€.**
Minimumi **5 projekte** do të financohen, **një për çdo rajon kryesor** (Zona Sipër Danubit, Zona në Mes të Danubit, Zona Poshtë Danubit, Delta e Danubit dhe Deti i Zi).
- **Tier 2 nga 500,000€ deri 1,000,000€.**
Minimumi **5 projekte** do të financohen, **një për çdo rajon kryesor** (Zona Sipër Danubit, Zona në Mes të Danubit, Zona Poshtë Danubit, Delta e Danubit dhe Deti i Zi).

Projekte të financuara priten të fillojnë në **Shtator 2026** dhe të zgjasin nga 18 deri në 30 muaj.

Kostot e pranueshme:

Kostot që mund të financohen përfshijnë shpenzimet drejtpërdrejtë për implementimin e projektit, personelin e përfshirë, pajisjet, aktivitetet e komunikimit dhe përfshirjen e komuniteteve, udhëtimet dhe partneritetet rajonale, gjithnjë duke respektuar rregullat e Horizon Europe dhe kufizimet e ndihmës shtetërore.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimet dorëzohen online përmes formularit të dedikuar në faqen zyrtare të thirrjes:

Application form: https://ec.europa.eu/eusurvey/runner/OC_CLed_SoS2LearnDBS_2025

Dokumentacioni përfshin **udhëzuesin për aplikantët, Technical Annex template, Budget Template** dhe **informacion mbi kriteret e vlerësimit** që mund të shkarkohen në faqen:

<https://sos2learndbs.eu/funding-calls/1st-sos2learn-danube-call-will-open-soon-documentation/#documentation>

Afati i fundit: data **30 Mars 2026**, ora 17:00 CET.

Linku i thirrjes:

<https://sos2learndbs.eu/funding-calls/1st-sos2learn-danube-call-will-open-soon-documentation/#documentation>